



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 61/2012
Prishtinë, më 02.05.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala, Hashim Deshishku, dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të ftuar: Përparim Kabashi- anëtar i Bordit nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe Ejup Hasolli - Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Pjesëmarrëse të tjerë: Ukë Gashi ZPRK; Shkamb Qavdarbasha dhe Dita Dobranja –INDEP; Agron Demi dhe Blerta Leci– GAP; Elizabeta Gjioda dhe Shkumbin Beqiri– KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.04.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për emërim të anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energji;
5. Shqyrtimi i Raportit me Propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Lutfi Zharku – Lidhur me rendin e ditës për pikën e katërt, lidhur me shqyrtimin e Propozim-vendimit të Qeverisë për emërim të anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, kishte vërejtje, pse është futur në rendin e ditës kjo pikë. Tha se, pasi që Komisioni e ka proceduar në seancën plenare dhe në seancë është hequr nga rendi i ditës, tani është çështje e Qeverisë sesi e procedon dhe e Kryesisë se kur e radhit në seancën tjetër.

Kryetari - Arsyeja pse është kthyer për shqyrtim Propozimvendimi i Qeverisë për emërim të anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, është pasi që jemi ngarkuar nga Kuvendi që të kemi konsultime shtesë me Qeverinë. Me rastin e raportimit të ministrit në mbledhjen e fundit, ai u deklarua se si Qeveri nuk kemi propozime të reja. Andaj, ne duhet tani ta procedojmë tutje këtë çështje.

Pas debatit, me katër (4) vota Për dhe tri (3) Kundër u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.04.2012

Procesverbali nga mbledhja e datës 24.04.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë në këtë pikë të rendit të ditës, do të raportojë përfaqësuesi nga Zyra e Rregullatorit për Energji, z. Përparim Kabashi, i cili do të paraqesë një ekspozë lidhur me Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2011.

Përparim Kabashi (Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji) – I njoftoi deputetët për hapat e deritashëm që ka marrë Zyra e Rregullatorit për Energji për përmbushjen e detyrimeve që i ka në bazë të Ligjit. Përfaqësuesi i kësaj Agjencie, Përparim Kabashi, duke vënë në dukje të arriturat foli për inkasimin në rritje të energjisë së shpenzuar në kuotën prej 2% dhe zvogëlimin e humbjes së energjisë në rrjetin e transmisionit. Duke iu referuar statistikave, të cilat ZRRE-ja posedon, Kabashi njoftoi se humbjet e përgjithshme arrijnë në kuotën prej 38% (17% janë në nivelin e shpërndarjes dhe 18% humbje komerciale). Përfaqësuesi i ZRRE-së, po ashtu njoftoi edhe për çmimin e energjisë. Lidhur me këtë, ai tha se energjia elektrike në Kosovë konsumohet me çmimin më të ulët në rajon. Duke folur për planet e ZRRE-së për të ardhmen, ai njoftoi se ZRRE-ja ka dhënë dhe do të vazhdojë të japë autorizime preliminare për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, ndërkaq, do të përpiqet që të ulë humbjet e energjisë elektrike. Tha se ZRRE-ja financohet nga të hyrat vetjake në pajtim me Ligjin për rregullatorin energjisë. Ai theksoi se ZRRE-ja gjatë vitit 2011, ka bërë edhe ndryshimin e legjislacionit, duke u bazuar në ligjet të cilat janë miratuar nga Kuvendi, siç janë: Ligji për energjinë, energjinë elektrike dhe Ligji për rregullatorin energjisë. Po ashtu, foli për mbështetjen që ka ofruar Komisioni Evropian, lidhur me prodhimin energjisë së ripërtëritshme, ku kanë marrë vendim që t'i mbështesin tregjet rajonale që të bëhet një treg i përbashkët për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Theksoi se në një pjesë të raportit janë paraqitur shënimet që janë marrë nga KEK-u.

Kryetari – Pyeti në lidhje me projektin për energjinë e ripërtëritshme: A ka investitorë të interesuar nga kompanitë e huaja që të investojnë për hidrocentralet dhe prodhimin e energjisë me erë, ku ka mbetur ky projekt?

Lidhur me humbjet e energjisë elektrike, cilët janë hapat që janë ndërmarrë për evitimin e këtyre humbjeve nga ZRRE-ja ?

Myzejene Selmani - Ngriti disa çështje që kishin të bënin me Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2011, si për humbjet në rrjetin shpërndarës të transmisionit, për rritjen e prodhimit të energjisë dhe konsumit se a ka planifikuar këtë problem ZRRE-ja. Të çështja e inkasimit dhe faturimit, në raport thuhet se është rritur inkasimi, por prapëseprapë Qeveria po duhet t'i japë subvencione KEK-ut. Pse nuk ka filluar ende projekti i linjës së transmetimit me Shqipërinë, kur dihet që kemi dhe grand nga Banka e Gjermanisë?

Visar Ymeri – Pyeti për çështjen e vazhdimin të licencave se ku është arsyeja. Pse po u jepen dhe lihen vetëm disa kompanive të njëjta dhe cili është vlerësimi i ZRRE-së për këto licenca?

Për privatizimin e Termocentralit “Kosova e Re” dhe privatizimin e distribucionit (rrjetit shpërndarës) pyeti: Cili është roli i ZRRE-së në këto procese? Për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike Pyeti: Cili është opinionin juaj për Qeverinë, si të kemi konkurrencë të lirë në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike? Në qoftë se privatizohet rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike, a do të ketë garanci nga kompania që do ta privatizojë se nuk do t'i kemi humbjet teknike të energjisë kaq të mëdha?

Teuta Sahatqija – Pyeti: Kur të privatizohet rrjeti shpërndarës, për rregullimin e blerjes së energjisë që kalon transit gjatë humbjeve teknike, si është e paraparë dhe kush do ta bartë kompensimin e humbjeve, kompania që e shet apo kompania që e blen? Për projektin e njehsorëve pyeti se kur do të fillojë ky projekt. Për çështjen marrëveshjes për fusnotë që ka bërë Kosova me Serbinë, pyeti: A ka paraqitur deri më tani ndonjë pengesë për ZRRE-në çështja e rregullimit të energjisë elektrike? Në fund, konstatoi se në bazë të të dhënave në raport, shihet se ende shumica e energjisë elektrike ka një konsum në amvisëri dhe është një barometër që si vend jemi larg zhvillimit ekonomik.

Lutfi Zharku – Pyeti lidhur me konstatimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, që ka konstatuar se Serbia ka bërë shkelje gjatë kalimit transit të energjisë elektrike për në Kosovë: A ka marrë masa apo vetëm e ka konstatuar shkeljen që ka bërë shteti i Serbisë ndaj shtetit të Kosovës? Kërkoj sqarim më të detajuar lidhur me projektin konkret të ZRRE-së sesi kanë planifikuar t'i përkrahin kompanitë që janë të interesuara për investime në sektorin e energjisë elektrike.

Sala Berisha – Shala – Pyeti për ankesat e konsumatorëve shtëpiakë lidhur me faturimin e energjisë elektrike, ku në raport janë shënuar një numër goxha i madh i ankesave të qytetarëve: A po shqyrtohen këto ankesa të qytetarëve nga ZRRE-ja dhe cilat janë vendimet e ZRRE-së për këto kategori, a janë në favor të konsumatorëve apo të KEK-ut?

Përparim Kabashi (Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji) – U përgjigj pyetjeve të deputetëve si në vijim: Sa i përket energjisë së ripërtëritshme tha se ne si ZRRE e kemi dhënë pëlqimin që të fillohet me këto projekte për investim në ndërtimin e disa hidrocentraleve dhe në vende të mundshme ku mund të ketë prodhim të energjisë me erë. Ndërsa lidhur me humbjet, kemi një humbje prej 38% në nivelin e shpërndarje së energjisë elektrike, kjo është kompetence e KEK-ut. ZRRE-ja në këtë rast, i ka rekomanduar KEK-ut që të punojë sa më shumë në uljen e humbjeve teknike të energjisë elektrike. Nëse privatizohet rrjeti, distribucioni shpërndarës, kompania ka kushte që çdo vit t'i zvogëlojë humbjet deri në 3%. Prodhimi i energjisë elektrike është rritur 2%, por në të njëjtin kohë kemi dhe rritje të konsumit. Për çështjen e inkasimit që

është në nivelin e KEK-ut, tha se janë përgjegjësi të vetë KEK-ut, sesi i furnizon konsumatorët e vet. Lidhur me çështjen e importit dhe eksportit në linjat nga Serbia, tha se këto janë probleme të natyrës politike, që kanë të bëjnë më çështjet e rregullimit të energjisë elektrike. Çështja e linjës së importit dhe eksportit me Shqipërinë prej 400 KV, tha se kjo është çështje e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, KOSTT-it dhe KEK-ut. Për humbjet tha se, ndonëse Kosova ka transit të lartë të energjisë elektrike krahasuar me konsumin, humbjet e shkaktuara nga transiti mbulohen përmes tarifave të rregulluara nga konsumatorët. Kosova nuk është përfshirë në mekanizmin rajonal për kompensimin ndërkufitar (mekanizmi ITC), si dhe nuk bën alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive, për shkak të problemeve me Serbinë. Në kontestin e ngritur më herët nga KOSTT-i në Sekretariatit të energjisë lidhur me këto çështje, Sekretariati ka dhënë opinionin e vet, i cili dokumenton shkeljet e bëra nga EMS (Serbia) të nenit 3 dhe nenit 6 të Rregullores (EC) 1228/2003, e cila ka të bëjë me kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë, por nuk ka marrë asnjë masë për shkak se vendimi duhet të merret në Këshillin e Ministrave të BE-së. Për projektin e ndërtimit të TC “Kosova e Re”, ZRRE –ja është vetëm anëtar në grupin e punës në komunitetin e projektit, ndërsa për privatizimin e rrjetit të distribucionit jemi anëtar vetëm në cilësinë e vëzhguesit, ndërsa për këto dy projekte ne i kemi dhënë opinionet dhe sugjerimet tona si ZRRE. Për liberalizimin e tregut dhe për çështjen e vazhdimin të licencave, tha se kjo është e rregulluar dhe me Ligjin për rregullatorin e energjisë dhe kërkesa e jonë është që të kemi konkurrencë në prodhimin energjisë së ripërtëritshme. Për çështje investitorëve për investim në sektorin e energjisë, tha se jemi të obliguar për kompanitë që aplikojnë, ZRRE-ja në bazë të Ligjit për rregullatorin energjisë, duhet t’u japë mundësi nëse i plotësojnë kushtet në marrjen e licencave investitorëve. Për çështjen e fusnotës, ai tha se ZRRE -ja është anëtare e barabartë me të gjithë rregullatorët e vendeve anëtare në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, nuk kemi pasur ndonjë problem në përfaqësim, por deri më tani jemi prezantuar me UNMIK. Për numrin e madh të ankesave të konsumatorëve të regjistruar që i përket kategorisë së konsumatorëve shtëpiakë. Bazuar në Rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në Sektorin e energjisë, ZRRE-ja ka kthyer në rishqyrtim në Departamentin për Konsumator në KEK 74 ankesa të konsumatorëve, pasi që ka vlerësuar se nuk janë zbatuar rregullat dhe procedurat në fuqi. Përveç ankesave të regjistruara, stafi i ZRRE-së gjatë këtij viti ka zhvilluar edhe 583 takime dhe 306 biseda telefonike me palët, të cilët janë drejtuar në zyrën për çështje të ndryshme kontraktuale midis konsumatorit dhe ndërmarrjes së energjisë. Gjatë komunikimit me palët, konsumatorët janë njoftuar dhe udhëzuar për rregullat, procedurat si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me furnizimin me energji, por nuk jemi të njoftuar nga KEK-u se në favor të kujt janë marrë vendimet, në favor të konsumatorëve apo të KEK-ut.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2011.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryetari – Theksoi se në seancën e fundit është shtyrë kjo çështje për konsultime shtesë me Qeverinë, pra propozimvendimit të Qeverisë për emërim të anëtarëve të Bordit të Zyrës së

Rregullatorit për Energji. Kur raportoi ministri Beqaj në mbledhjen e fundit, ai u deklarua se si Qeveri nuk kemi propozime të reja. Andaj, ne duhet tani ta procedojmë tutje këtë çështje.

Lutfi Zharku – Theksoi se ne kemi shkresë nga Kuvendi që vetëm jemi njoftuar dhe nuk jemi të obliguar proceduralisht të shqyrtojmë këtë çështje, sepse ne si Komision e kemi përfunduar një herë.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. *Pas konsultimeve shtesë me Qeverinë, Komisioni nuk ka marrë propozime të reja lidhur me Propozimvendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.*
- II. *Të njoftohet Kryesia dhe Kuvendi lidhur me këtë çështje për radhitje në seancë plenare si pikë e rendit të ditës.*

5. Shqyrtimi i Raportit me Propozimamendamente për Projektligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet elektronike

Kryetari – Ia dha fjalën raportueses së grupit të punës, znj. Teuta Sahatqija që të paraqesë Raportin me propozimamendamente, edhe pse ishte i pajtimt që kjo pikë të shqyrtohet në një mbledhje të radhës.

Teuta Sahatqija – Theksoi se sot kemi pasur edhe një takim me ministrin e Zhvillimit Ekonomik në lidhje me disa amendamente dhe kërkoi që të shtyhet kjo pikë e rendit të dtiës në mbledhjen e radhës, për shkak të përgatitjes dhe analizimit të amendamenteve të dala si përfundim nga mbledhja e grupit të punës

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Raportit me Propozimamendamente për Projektligjin nr .04/L-109 për Komunikimet elektronike në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit